



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Brendshme
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

U r d h ë r

Nr. __981__ datë _31.10. 2008

Për

Masat që do të merren nga Policia e Shtetit për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje, trajtimin e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare

Bazuar në nenin 20 të Ligjit nr. 9749 datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit"; të Ligjit nr.9669 datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", urdhërin e MB Nr. 379 datë 03.03.2008 "Për masat që do të merren për parandalimin e reduktimin e dhunës në familje, trajtimin e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare",

Me qëllim, marrjen e masave policore për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në marrëdhëniet familjare, garantimin e mbrojtjes ligjore dhe rritjen e sigurisë për anëtarët e familjes ndaj të cilëve ushtrohet dhunë, parandalimin e krimeve të rënda që mund të vijnë si pasojë e ushtrimit të dhunës në marrëdhëniet familjare,

URDHËROJ :

1. Drejtuesit e drejtorive të policisë në qarqe dhe shefat e komisariateve, të marrin masa për njohjen dhe zbatimin nga personeli i të gjitha niveleve të Ligjit nr.9669 datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare". Vemendje e vecantë ti kushtohet sidomos neneve që bëjnë fjalë "Për detyrat e autoriteteve përgjegjëse të linjës", "Përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse" dhe "Masat

mbrojtëse ndaj dhunës në familje" parashikuar respektivisht në nenet 7; 8 dhe 10 të këtij ligji.

2. Drejtuesit e drejtorive të policisë në qarqe dhe të komisariateve të policisë në rrethe të organizojnë punën me shërbimet e policisë së strukturave të rendit dhe sigurisë publike dhe të parandalimit të krimit e policimit në komunitet, strukturat kundër krimeve të rënda, të sallave të drejtimit dhe komandimit :

2.1. Për zbatimin e legjislacionit penal për çështjet që kanë të bëjnë me dhunën në familje,

2.2. Për hetimin e plotë, objektiv e dokumentimin ligjor të rasteve të dhunës në familje,

2.3. Për vlerësimin dhe marrjen e masave nga punonjësit e policisë të sallave të drejtimit dhe komandimit të telefonatave që bëjnë fjalë për dhunën në familje,

3. Shërbimet e policisë së strukturave të rendit dhe sigurisë publike dhe të parandalimit të krimit e policimit në komunitet, në nivel vendor në vazhdimësi të organizojnë punën:

3.1. Për parandalimin dhe marrjen e masave mbrojtëse ndaj dhunës në familje duke informuar në çdo rast viktimat për masat mbrojtëse të parashikuara në ligj, (neni 10 i Ligjit).

3.2 Për marrjen e masave për përgatitjen dhe dërgimin në Gjykatën e Shkallës së Parë të kërkesës për Urdhër-Mbrojtje ose Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtjeje, për viktimat e dhunës në familje.

3.3 Për garantimin e masave mbrojtëse në zbatim të Vendimeve të dhëna nga Gjykatat "Për lëshimin e Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes", "Urdhërit të Mbrojtjes".

3.4 Për komunikimin dhunuesve të masave mbrojtëse dhënë nga Gjykatat në vendimin "Për lëshimin e Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes", "Urdhërit të Mbrojtjes".

3.5 Për plotësimin në çdo rast të kartelës "Kartelë e personit të dëmtuar nga dhuna në familje", në tre kopje, ku një kopje të administrohet në sekretarinë e komisarariatit të policisë dhe dy kopje të dërgohen pranë Seksionit të Mbrojtjes së të Miturve dhe Dhunës në Familje në Drejtorinë e Policisë në Qarqe. (Kartela bashkëlidhur).

4. Strukturat policore kundër krimeve të rënda, dhe ato të rendit dhe sigurisë publike dhe të parandalimit të krimit e policimit në komunitet, në nivel vendor, në vazhdimësi të organizojnë punën:

4.1 Per evidentimin, dokumentimin dhe ndjekjen me përgjegjësi të të gjitha denoncimeve apo kallzimeve të bëra për rastet e dhunës në familje, duke bërë referimet përkatëse në organin e Prokurorisë:

4.2 Në bashkpunim dhe bashkërendim me strukturat e rendit dhe sigurisë publike dhe të parandalimit të krimit e policimit në komunitet, të merren masa për parandalimin e veprave penale në ambientet familjare dhe mbajtjen nën kontroll të individëve që janë të dhunshëm si në shoqëri dhe në familje.

4.3 Seksioni për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunës në Familje në Drejtorinë e Policisë në Qarqe, brenda datës 5 të çdo muaji, të dërgojë pranë Sektorit të Mbrojtjes së të Miturve dhe Dhunës në Familje në Drejtorinë kundër Krimeve të Rënda, një kopje të kartelave, "Kartelë e personit të dëmtuar nga dhuna në familje", shoqëruar me një relacion shpjegues.

5. Drejtuesit e policisë në qarqe, shërbimet e rendit dhe sigurisë publike dhe parandalimit të krimit e policimit në komunitet, strukturat policore kundër krimeve të rënda të bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme me njësitë e qeverisjes vendore (bashki e komuna), me qendrat ose njësitë shëndetësore, me OJF-te e licensuara për ofrimin e shërbimeve, që operojnë në juridiksionin e tyre, me qëllim parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje dhe trajtimin e rehabilitimin e viktimave.

6. Drejtuesit e drejtorive të policisë në qarqe dhe komisariateve të policisë në rrethe, të analizojnë dhe të vënë para përgjegjësisë administrative dhe penale, punonjësit e policisë që neglizhojnë zbatueshmërinë e ligjit gjatë trajtimit të çështjeve të dhunës në marrëdhëniet familjare.

7. Departamenti për Hetimin Kriminal – Drejtoria kundër Krimeve të Rënda dhe Departamenti i Rendit dhe Sigurisë Publike - Drejtoria e Rendit Publik të hartojnë Metodikë "Për procedurat standarte të vlerësimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në familje".

7.1 Metodika t'u vihet në dispozicion të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit në nivel qendror dhe vendor që trajtojnë rastet e dhunës në familje.

8. Me këtë urdhër të njihen të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit.

9. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen Drejtoria kundër Krimeve të Rënda Drejtoritë e Policisë në Qarqe dhe Komisariatet e Policisë në rrethe si dhe strukturat vartëse të tyre.

10. Për kontrollin e zbatimit të këtij urdhëri ngarkohen Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm për Hetimin Kriminal dhe Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i për Sigurinë Publike.

11. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Drejtori i Përgjithshëm

Ahmet PRENÇI

Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm
(për Hetimin Kriminal)
Agron KULICAJ

Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm
(për Sigurinë Publike)
Rasim BORISHI